



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 10934 prot.

Shkodër, më 30 . 5 . 2025

VENDIM

Nr. 32, datë 29.05.2025

**“PËR MIRATIMIN E ‘PLANIT TË PËRBASHKËT TË MENAXHIMIT TË RREZIKUT
NGA ZJARRI’ NË KUADËR TË PROJEKTIT ‘BUILDING SMART FORESTS’ ”.**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 29.05.2025 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, bazuar nenin 27 pika 5, nenin 54 të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar ; **nenin 30** pika 4, gjerat ‘b’ dhe ‘c’ të **ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”**; Ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”; Ligjit Nr. 9693, datë 19.3.2007: “Për fondin kullosor”, të ndryshuar; Ligjin nr. 158/2021 “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, Malit të Zi, përfaqësuar nga Zyra e Integritimit Europian dhe Komisionit Europian për programin e veprimtimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi - Shqipëri 2014 - 2020, alokimet për vitin 2019; Ligjin nr. 38/2020 “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian për programin e bashkëpunimit ndërkufitar IPA II Mali i Zi- Shqipëri, alokimet e vitit 2018; Ligjin nr. 21/2019 “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian për programin e bashkëpunimit ndërkufitar IPA II Mali i Zi-Shqipëri, alokimet e vitit 2017;

Projektit nr. 33 “Building Smart Forests”, në kuadër të programit të bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi – Shqipëri 2014-2020 nën Instrumentin e Asistencës së Para-Aderimit (IPA II), me referencë EuropeAid/171769/ID/ACT/Multi; kontratën e grantit CFCU/MNE/221 datë 22.12.2022, të lidhur ndërmjet Foundation for Local Autonomy and Governance (FLAG), në cilësinë e Koordinatorit dhe Ministrisë së Financës së Malit të Zi, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues; Marrëveshjen e Partneritetit nr. 3046prot., datë 01.03.2022 të lidhur ndërmjet Foundation for Local Autonomy and Governance (FLAG), në cilësinë e Koordinatorit, Bashkisë Shkodër dhe Komunës Tivar.

VKM-në nr. 1080, datë 22.12.2010 “Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota”; VKM-në nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarëve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, të ndryshuar; VKM nr. 59, datë 26.01.2022 “Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe sipërfaqes së ekosistemeve natyrore park kombëtar (kategoria II) të zonave të mbrojtura “; VKM-në nr. 60, datë 26.01.2022 “ Shpallja e ekosistemeve natyrore rezervat natyror i menaxhur /Park Natyror (kategoria IV) , si dhe miratimin e ndryshimit të statusit e të sipërfaqeve ekzistuese të zonave të mbrojtura mjedisore, që i përkasin kësaj kategorie” si dhe dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër;

VENDOSI:

1. Të miratojë **“Planin e përbashkët të menaxhimit të rrezikut nga zjarri”**, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 34 vota

Vota Pro	34
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	30.05.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj

